



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:264865

Datë: 28.02.2024

Numri i dokumentit: 05386198

C.nr.3872/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Njomëza Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale D.A. në çështjen juridike kontestimore të paditëses M.M. me numër personal ... nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria për Arsim, të cilën e përfaqëson V.I.Xh. me objekt të padisë kompensimi i shujtave, vlera e kontestit 274.00, € jashtë shqyrtimit kryesor, me datë **28.02.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M
Pa shqyrtim kryesor të çështjes

- I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses M.M. nga Prizreni.
- II. DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit, që paditëses M.M. nga Prizreni, në emër të kompensimit për shujta ditore nga data 03.01.2022 e deri me datën 21.11.2022 për gjithsej 137 ditë pune, t'ia kompensojë shumën prej 274.00€, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data e parashtrimit të padisë (16.11.2023) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.
- III. DETYROHET** e paditura që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore shumën prej 124 € (njëqind e njëzet e katër) euro në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja M.M. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi me datë 16.11.2023, me kërkesë për kompensimin e shujtave ditore për ushqim në punë për periudhën 03.01.2022 – 21.11.2022, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria për Arsim. Në padi ka theksuar se paditësi në cilësinë e mësimitdhënësit në institucionin arsimor Sh.F.M.U “Dy Dëshmorët” në Piranë, KK Prizren, nuk i ka pranuar mjetet e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë në vlerë prej 2 euro në ditë siç parashihet me kontratën kolektive të arsimit në Kosovë, përkatësisht kontratës kolektive të Arsimit e vitit 18.04.52017 nr.2056 neni 35 par.7 dhe Kontratës së Arsimit nr. 105 e datës

22.01.2021 nenit 35 par.7 dhe se paditësi prej 03.01.2022 e deri me 21.11.2022 ka shkuar në punë gjithsej 137 ditë pune, ndërsa e paditura nuk e ka kompensuar paditësin për ditët e punës së kësaj periudhe që i bie në shumë të përgjithshme prej 274.00€. Në këtë drejtim i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta aprovojë si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes përfaqësueses ligjore të komunës në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, lidhur me kompensimin e shujtës ditore. Ka theksuar se bazuar në njoftimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me numër 01B/488 të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021, padia dhe kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar. Po ashtu sipas të autorizuarit të të paditurës përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësja nuk ka ofruar ndonjë provë që është anëtarë i sindikatës. Po ashtu ka theksuar se të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-193. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditëses është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e saj. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësja M.M. është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht mësimdhënëse në Institucionin arsimor Sh.F.M.U “Dy Dëshmorët” në Piranë, Komuna e Prizrenit.

Nga vërtetimi i lëshuar nga drejtori i të shkollës nr.156/2023 të datës 07.11.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësja M.M. nga Prizreni është në marrëdhënie pune-mësimdhënëse pranë këtij institucioni dhe e njëjta në vitin 2022 për periudhën nga data 03.01.2022 e deri më 21.11.2022, ka gjithsej 137 ditë pune.

Vërtetimin e lartcekur, Gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, të cilës gjykata ia fali besimin e plotë pasi që e njëjta është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e i cili si i tillë është i pranueshëm edhe për vetë palën e paditur.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01/B, nr. prot. 105, e dt.22.01.2021, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Me nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01B, nr. prot. 105, e datës 22.01.2021 është përcaktuar e drejta e punëtorëve në kompensimin e shujtave dhe atë *“Të punësuarve (anëtare të SBAShK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...”*.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 134 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*, pasi që e paditura ka pasur për detyrim që paditëses si punëtores e arsimit-mësimdhënëse, t’ia paguaj kompensimin e shujtave, konform detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit me numër 01/B, numër të prot. 105 e datës 22.01.2021, neni 35 paragrafi 7, pasi që për paditësen M.M. kërkesa është bërë e arritshme për 137 ditë pune për vitin 2022, apo shuma e përgjithshme prej 274,00 €.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (16.11.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritore.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.3872/23, datë 28.02.2024

B. Profesionale
Delvina Ajazaj

Gjyqtarja
Njomëza Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.